



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

-
-
-
-
-

Kronikë

Atentat i dështuar në Elbasan/ Tentoi të vriste 50-vjeçarin në një lokal, por iu bllokua arma! Arrestohet autori (VIDEO)

Një atentat është regjistruar në një lokal në qytetin e Elbasanit. Teksa qëndronte i ulur në një tavolinë me bashkëshorten në lokal, Poli Boriçi 52 vjeç është ngritur dhe është drejtuar drejt një klienti që po dilte jashtë lokalit, Ermir Kërtezi 50 vjeç për ta vrarë

■ Policia sekuestron armën e zjarrit të autorit

Atentat i dështuar në Elbasan/ Tentoi të vriste qytetarin por i ngeci arm

Report TV

Watch on

Redaksia

15 Gusht, 16:06 | Përditësimi: 15 Gusht, 20:57

SharePost

ELBASAN - Një atentat i dështuar është regjistruar pak pas mesditës të kësaj të shtune në një lokal në hyrje të qytetit të Elbasanit. Një 52-vjeçar i ulur në një lokal është çuar dhe i ka vënë pistoletën në kokë një personi i identifikuar si Ermir Kërtezi, 50-vjeç. Arma nuk ka shkrepur dhe objektivi është larguar me vrap duke shpëtuar mrekullisht. Autori **Poli Boriçi** është arrestuar vetëm pak minuta më pas.

Ky është momenti kur, Poli Boriçi, 53-vjeçar i vendos pistoletën në kokë Ermir Kërtezit në Elbasan në tentativë për ta ekzekutuar, por pistoleta nuk shkrepet dhe 50-vjeçari shpëton për mrekulli. Efekt

Ngjarja e ndodhur rreth orës 12:40 të së shtunës i shtangu të gjithë të pranishmit në lokalin në hyrje të qytetit të Elbasanit, i cili në ato momente ishte plot me klientë.

LEXO EDHE:

Tentoi të vriste 50 vjeçarin në Elbasan, pas arrestimit autorit i sekuestrohet edhe pistoleta (VIDEO)

Gjithçka ndodhur për 37 sekonda. Në pamjet e siguruara nga Report Tv duket objektivi i atentatit, 50-vjeçari Kërtezi, i veshur me bluzë të zezë. Ai fillimisht ndodhej brenda lokalit, kalon mespërmes ambienteve të jashtme të barit, dhe ndalet për pak sekonda jashtë.

Por lëvizjet e tij duket se janë ndjekur nga një tjetër person, i veshur me të bardha, me kapele të zezë, dhe në çantën e varur në trup mbante armën pistoletë. Atentatori Poli Boriçi ishte në kafe në shoqërinë e bashkëshortes.

52-vjeçari Boriçi çohet menjëherë, nxjerr pistoletën, ia vendos në kokë Kërtezit por arma i bllokohet. Objektivi reagon shpejt, shtyn atentatorin e tij, dhe ka arritur të largohet me shpejtësi. Boriçi e ka ndjekur për pak metra personin që donte ta eliminonte dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes. Por arratia i ka zgjatur vetëm pak pasi policia ka mundur ta lokalizojë dhe ta arrestojë.

Njëkohësisht, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës, armën e zjarrit pistoletë me të cilën autori 52-vjeçar tentoi të vriste 50-vjeçarin. Momenti i arrestimit

Deri tani, motivi mbetet i paqartë dhe pritet të jetë një prej pikave kryesore të hetimit.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Atentat i dështuar në Elbasan/ Tentoi të vriste 50

Report TV

Watch on

Share

Rendit zhvillimet sipas orarit:

Të Fundit

Ora 17:52 Tentoi të vriste 50 vjeçarin në Elbasan, pas arrestimit autorit i sekuestrohet edhe pistoleta (VIDEO)

Tentoi të vriste 50 vjeçarin në Elbasan, pas arres

Report TV

Watch on

Uniformat blu kanë reaguar pas atentatit të dështuar në një lokal në Elbasan.

Pas arrestimit të 52-vjeçarit blutë bëjnë me dije se kanë sekuestruar edhe armën e zjarrit, pistoletë.

Njoftimi i policisë

Pas marrjes së njoftimit, rreth orës 13:00, se në ambientet e jashtme të një lokalit, në lagjen “28 Nëntori”, Elbasan, një shtetas kishte tentuar të vriste me armë zjarri shtetasin E. K., 50 vjeç, shërbimet e Policisë organizuan punën për identifikimin dhe kapjen e autorit.

Falë reagimit të menjëhershëm të Policisë dhe veprimeve profesionale të kryera në kuadër të operacionit “Reagimi”, u bë i mundur identifikimi dhe kapja e autorit të dyshuar, shtetasit P. B., 52 vjeç.

Njëkohësisht, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, armën e zjarrit pistoletë me të cilën autori tentoi të vriste 50-vjeçarin.

Nën drejtimin e Prokurorisë, vijojnë veprimet hetimore dhe procedurale për sqarimin e rrethanave dhe dokumentimin e plotë ligjor të rastit.

Xh.K/Shqiptarja.com

Share

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Poli Boriçi tentative vrasje Elbasan Ermir Kërtezi

Sa e vlerësoni këtë artikull? 3.1 / 5 (10 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Nardi:

15/08/2026 18:46

Ne e leme mbropa meksiken! Ata jane te mbaruar! Ne te fikim ne pazar! Dhe ky i gjori kushedi si e ka patur hallin dhe shkoi ta vriste por nuk ndodhi! Jetejgati nuk behet jeteshkurter. Po si popull ne ja kalojme meksikes!

hmm:

15/08/2026 18:44

admiroj qetesine e zonjes

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Cili është shkaku i konflikteve në Shqipëri?

15 Gusht, 13:45

Politika Shoqëria Social media

Lajme të tjera

-
- Shembet dhe del jashtë shtratit kanali vaditës, hapet pas disa orësh qarkullimi në rrugën Elbasan-Cërrik
- 15 Gusht, 13:20

Banorët denoncuan bllokimin, IKMT liron burimin dhe kanalin e ujitjes së tokave në Mirakë të Librazhdit

14 Gusht, 11:49

Lufta me flakët edhe për faunën, arusha me këlyshin e saj fotografohet në Elbasan

13 Gusht, 20:12

14 vatra zjarri aktive në Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: Situatë e rënduar në Gurë-Lurë të Dibrës dhe Elbasan! Flakët në 'kurorën' e Tiranës vihen nën kontroll

13 Gusht, 18:44

Zjarr në fshatin Lugaxhi të Elbasanit, i afrohet zonave të banuara (VIDEO)

13 Gusht, 14:51

Arre pistoletë në çantë, me shatërvan 21-vjeçari në Elbasan

13 Gusht, 13:58

Klasa të reja, laboratorë dhe terrene sportive, si po transformohet shkolla 'Mehmet Bajraktari' në Cërrik

13 Gusht, 13:55

Kamioni përplasjet me autobusin me pasagjerë në aksin Elbasan-Peqin, nuk ka të lënduar (VIDEO)

11 Gusht, 13:13

Korridor VIII/ Banorët e Librazhdit protestojnë: Na është rritur distanca, duam hyrje të re në 'Elbasan-Qafë Thanë'

10 Gusht, 16:58

Autostrada Elbasan-Sqarozhinë, ARRSH sqarozhinë deri në Elbasan! Një lidhëse është pjesë e projektit, por do të ndërtohet më vonë

10 Gusht, 16:13

Refuzohet kërkesa e Ardian Çapjas për t'i dhënë lamtumirën nënës së ndjerë! Burime: Policia nuk mori përsipër sigurinë

10 Gusht, 13:49

Dogji 3 makina, arrestohet 43-vjeçari në Elbasan! Në pranga edhe një tjetër, u kap me pistoletë, fishekë e kokainë

8 Gusht, 11:15

CMIMI MË I MIRË 15.999 -36% 24.999

Tërbator Haskari 43* 8000 TË TË KËRKA 1000 VOA CH. MEGAL R.254. Kap. 510000

Migrobank

Migrobank

HOROSKOPI

Lajmi i fundit

Korea e Jugut propozon bisedime për t'i dhënë fund zyrtarisht luftës me Korenë e Veriut

15 Gusht, 22:44



